

Bashkia: BERAT

Kryetar: PETRIT SINAJ

Fusha: INFRASTRUKTURË DHE SHËRBIME PUBLIKE

Premtime:

1. Do të hartohet një plan rregullues për gjithë stadiumin e ri dhe zonën përreth
2. Do të përmirësohet infrastruktura rrugore në territorin e bashkisë
3. Do të rikonstruktohet rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza në territorin e bashkisë
4. Do të asfaltohen të gjitha rrugët kryesore dhe dytësore në qytet e në fshat, si dhe do të shtrohen të gjitha rrugicat në qytet dhe në fshatra të ndryshëm me kalldrëm (aty ku përshtaten)
5. Do të rehabilitohet rrjeti i shpërndarjes së furnizimit me ujë për qytetin dhe fshatrat përreth
6. Do të rehabilitohen dhe rikonstruktohen rrugët e lagjeve, veçanërisht në ato muzeale
7. Do të ofrohen qendra shëndetësore në territorin e bashkisë
8. Do të vendosen lulishte në lagjet mes pallateve në territorin e bashkisë
9. Do të kryhet rehabilitimi i lumit dhe përfitimi i një hapësire prej 4-5 hektarë
10. Do të restaurohet rruga tek Rajoni numër 2, nga qarku deri tek stadiumi i vjetër dhe nga satadiumi i vjetër deri tek stadiumi i ri
11. Do të rikualifikohen fasadat në hyrje të qytetit: Rikualifikim i fasadave të objekteve në ndëtim dhe kolor; Unifikim i elementëve kufizues në material, stil dhe lartësi
12. Do të rikualifikohet dhe rikonstruktohet rruga "Muzak Topia": Do të kthehet në një aks komod, lehtësisht i aksesueshëm me parametra bashkëkohor; Zgjidhje definitive e funksionale në veprat e artit; Kënde shplodhjeje dhe relaksit përgjat rrugës "ballkone vrojtimi"; Sistem ndriçimi dekorativ dhe funksional; Shesh parkimi në qafën e kalasë

Fusha: ARSIM/KULTURË/SPORT

Premtime:

1. Do të rritet numri i shkollave e kopshteve dhe do të rikonstruktohen të gjitha shkollat , kopshtet, çerdheve në territorin e bashkisë duke u pajisur me bazë materiale të kohës
2. Do të jepen bursa për nxënësit ekselentë
3. Do të sigurohet sistemi i ngrohjes për të gjitha shkollat e bashkisë së re, atje ku mungojnë
4. Do të rehabilitohet stadiumi i vjetër
5. Do të jepen, me rastin e festave të fundvitit, shpërblim për të gjithë stafin pedagogjik, ndërkaq nga fondi i bashkisë do të jetë një zë i veçantë për çdo shkollë, i cili do të jetë në dispozicion për t'u administruar nga drejtorja e shkollës
6. Do të shtohet buxheti për sportin, kulturën, arsimin në masën deri 50%
7. Do të ngrihet një qendër rinore multifunksionale në territorin e bashkisë

Fusha: MJEDIS/TURIZËM

Premtime:

1. Do të shtohen lulishtet dhe parqet në territorin e bashkisë
2. Do të promovohet Parku Kombëtar i Tomorit, si një zonë ende e pashfrytëzuar dhe sigurimi i këtij parku me infrastrukturë të nevojshme për ta kthyer në një pikë referimi të turizmit
3. Do të përmirësohet transporti publik, si dhe do krijohen parkingje për automjetet e turistëve, për shfrytëzimin e qendrës historike e sidomos kalanë
4. Do ti jepet përparësi zhvillimit të agro turizmit në mënyrë që të gjenerohen vende të reja pune
5. Do të rehabilitohet Kalaja e Beratit, Faza II (vlera 1.7 milionë euro, me financim të KE)
6. Do të rehabilitohen të gjitha zonat e mbrojtura si Gorica dhe Mangalem
7. Do të vendoset teleferik në anën lindore të Mangalemit, me destinacion kalanë e qytetit
8. Do të kryhet promovim i vlerave të qytetit me anë të faqeve në internet
9. Do të bashkëpunohet me Drejtoritë e Monumenteve dhe Muzeun Onufri për të pasur një zë për investim në turizmin historik dhe kulturor që qendrat historike të ruhen nga erozioni. Për këtë do evidentohen rreziqet më adekuate dhe do marren masat e nevojshme
10. Do të bëhet efikas sistemi i hidranteve për ruajtjen e zonave muzeale si dhe një postë emergjente në hyrjen në Kala
11. Do të mundësohet pastrimi i zonave muzeale me mjete motorike të depërtueshme nëpër këto lagje si dhe pajisjen me kontenier të ndarë sipas mbetjeve

Fusha: BUJQËSI

Premtime:

1. Do të ketë angazhim maksimal në krijimin e ambienteve të përshtatshme për tregëtarët e vegjël në territorin e bashkisë
2. Do të ofrohet sistemi i kullimit në territorin e bashkisë
3. Do të ngrihet një sistem modern vaditje në të gjitha zonat rurale
4. Do të ndërtohen tregje të reja në pika strategjike hyrëse dhe dalëse të qytetit, që të lidhen në mënyrë funksionale dhe organike me njësitë administrative dhe me qytetin
5. Do të marrë fund praktika e mëparshme e kazanëve ku mbetjet digjeshin, apo zona të tëra ktheheshin në toksike duke helmua dhe ujërat; Do të zbatohet një projekt për një landfill në Berat, gjë që ndarja e re administrative e kërkon si domosdoshmëri emergjente
6. Do të krijohet drejtoria e bujqësisë në bashki që do të merret me ngritjen e sistemit të vaditjes, kullimit dhe do të nxisë prodhimet bujqësore të zonës nëpërmjet kredive të buta financiare ku bashkia do të jetë dorëzane në bankat e nivelit të dytë për ata fermerë që plotësojnë disa kushte dhe lidhin kontrata
7. Do të organizohen panaiere për produktet e zonës si ulliri, fiku, rrushi, vera, rakia dhe drejtoria e bujqësisë në bashki do të negociojë me firmat e bizneseve si koordinatorë për shitjen e këtyre produkteve, përkundrejt një takse simbolike pas shitjes së prodhimit

Fusha: TRANSPARENCA

Premtime:

1. Do të ketë transparencë për çdo qindarka që do të investohet nëpërmjet faqeve online, por edhe nëpërmjet buletineve do të bëjnë të mundur që qytetarët të dinë çfarë po bëhet me paratë dhe taksat e tyre
2. Do të sigurohet transparenca nëpërmjet njohjes së administratorëve me taksat e mbledhura si zona dhe investimet që do të bëhen mbi bazën e prioriteteve

Fusha: SHËRBIMET SOCIALE

Premtime:

1. Do të krijohen ambiente çlodhjeje dhe argëtimi për moshën e tretë në territorin e bashkisë
2. Do të ngrihet një shkolle profesionale për anëtarët e komunitetit rom me qëllim kualifikimin dhe punësimin e tyre në territorin e bashkisë
3. Do të ndërmjetësohet me biznesin fason që në përputhje me një lehtësim të taksave të rrisë numrin e romëve të punësuar në këto fasone
4. Do të hapet një azil për moshën e tretë në territorin e bashkisë

Fusha: EKONOMI DHE PUNËSIM

Premtime:

1. Do të zbutet papunësia ndjeshëm, duke i dhënë biznesit private qira me 1 euro në vit
2. Do të ulen taksat e biznesit me kusht gjenerimin e vendeve të reja të punës
3. Do të rritet roli i gruas në vendimmarrjen vendore
4. Në vitin e parë të mandatit parashikohet të arrijë deri në 1000 të punësuar nga Bashkia e Beratit
5. Gratë dhe vajzat do të zenë gjysmën e këshillit bashkiak
6. Do të ketë koordinim me biznesin që merret me infrastrukturën dhe shtrimet e rrjeteve nëntokësore në mënyrë që të gjenerohen vende të reja pune
7. Do të zbutet papunësia me përfshirjen e të rinjëve në strukturat shtetërore
8. Do të mbështeten financiarisht dhe nxiten iniciativa private që synojnë hapjen e vendeve të reja të punës dhe zhvillimin e zonës
9. Synohen trajnime në profesione të ndryshme për të fituar një pagë minimale nga paketa e nxitjes së punësimit
10. Synohet zëri që do marrë punësimi të jetë 10-15% e buxhetit të bashkisë